COMUNE DI RAVENNA
Area Infanzia, Istruzione e Giovani
Servizio Nidi e Scuole dell'Infanzia

Servizi per l'Infanzia
0-6 anni

Consorzio Servizi Educativi
zerocento
il cerchio
Cooperativa Sociale IL CERCHIO

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI RECIPROK NDËRMJET KOMUNËS SË RAVENËS SHËRBIMET E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE DHE PRINDËRVE TË FËMIJËVE QË I FREKUENTOJNË ATO**

Në zbatim të "Projektit Pedagogjik të ciklit para-shkollor nga 0-6 vjeç"të Komunës së Ravenës ;përshtatur me Rezolutën e Këshillit P.G. n. 729 të 6 dhjetorit 2018;

E ashtuquajtura Laura Rossi, në rolin e Drejtoreshës së Shërbimit të Ciklit Parashkollor të Komunës së Ravenës, bashkarisht me Francesca Travaglini në rolin e Këshilltares ligjore të Konsorciumit Dadonew Shërbimet Arsimore me të cilët janë kontraktuar çerdhet komunale me menaxhim të jashtëm nga 01/09/2022 deri me 31/08/2025,

dhe

I ashtuquajturi/a ______________________________ lindur në ____________________me ______________ prind (apo tutori ose kujdestari me titull dhe përgjegjshmëri prindërore)_________________________ __________________________________________ ________________________________________________ frekuentues i çerdhes /kopshtit komunal

**Duke parë**

- Vullnetin e shprehur nga Shërbimet e Ciklit Para-shkollor, në kontekstin e identitetit dhe vlerave metodologjike të Projektit Pedagogjik të latpërmendur,
- për të afirmuar shërbimet e ciklit para-shkollor si vend ku duhet të respektohen të drejtat e fëmijëve , në rradhë të parë e drejta për edukim, duke i garantuar mundësi të barabarta, duke respektuar dallimet dhe në rradhë të dytë si "mundësi" i domosdoshëm përsa i përket rrugëtimit ndaj edukimit dhe qytetarisë ,
- Promovimi i vazhdueshëm ndaj kujdesjes dhe mirëqënies globale, të zhvillimit origjinal të identiteve, të potencialiteteve dhe aftësive emocionale, sociale dhe njohëse të çdo fëmije, përmes planifikimit dhe përvojave të synuara,
- la tensione continua alla costruzione di una alleanza con le famiglie, come base fondamentale per il buon clima all'interno dei servizi educativi e costitutiva del benessere e della serenità dei bambini/e nel contesto della loro esperienza scolastica,
- - tensioni vazhdon ndaj krijimit të një aleance me familjet , si bazë thelbësore për krijimin e një klime të mirë në brendësi të shëbimeve edukative dhe ndikuese në qetësinë dhe mirëqënien e fëmijëve në kontekstin e eksperiencës së tyre shkollore,

Idea e çerdhes/shkollës si "komunitet edukues", joformale, ku mund të ndash gjërat bashkë, i mbushur me gjuhë afektive dhe emocionale, në të cilët ushtrohet dialogu dhe për fëmijët, i bazuar mbi takimin me të tjerët, mbi dëgjimin reciprok dhe mbi vëmendjen per nga këndvështrimi i të tjerëve, në të cilin fëmijë dhe të rritur kanë sjellje normale, bazuar në respektin reciprok si dhe në respekt të rregullave të brendshme të Shërbimit , me qëllim për të siguruar mbarëvajtjen e eksperiencave parashkollore te

çerdheve dhe kopshteve komunale, që mbështesin të drejtat e fëmijëve për tu edukuar, socializimit dhe mirëqënies ,

**konsideruar**

- që Projekti Pedagogjik i sipërpërmendur, thërret nevojën e një bashkëpunimi aktiv të familjeve për mbarëvajtjen e shërbimeve, duke nxitur përhapje të gjërë të përgjegjsisë së përbashkët dhe kolektive, që duhet shprehet mbi të gjitha përmes një "marrëveshje arsimore" mes mësuesve e prindërve, në ndërtimin progresiv të besimit të ndërsjellë dhe të një "aleance" të vërtetë, me vetëdijen për të kontribuar në një projekt edukativ në favor të fëmijëve, në respektim të roleve dhe qëllimeve të përbashkëta,

**nënshkruajnë**

- marrëveshja e mëposhtme e bashkëpunimit, e natyrshme për pranimin dhe ndarjen e strukturës organizative të ciklit 0-6, zbatim i planifikimit mësimor dhe didaktik , për të favorizuar zhvillimin e kompetencave, njohëse dhe sociale të fëmijëve dhe në veçanti përvojave arsimore që lidhen shprehimisht me Projektin Pedagogjik të ciklit 0-6 vjeç, të metodave për të marrë pjesë në jetën komunitare të çerdheve/ shkollave dhe të rregullave, të cilat pasqyrojnë realitetin shkollor dhe që favorizojnë mbarëvajtje, promovimin e mirëqënies dhe mbrojtje të shëndetit të kolektivit.

- **Drejtoresha e Shërbimit të Çerdheve dhe Kopshteve të Komunës së Ravenës,dhe Përfaqsuesi ligjor Dadonew Consorzio Shërbimet Arsimore deklarojnë:**

- Të promovojë ndëtimin e një aleance pozitive dhe të hapur mes mësuesish, edukatorësh dhe familjesh, me qëllim bashkëpërgjegjësinë dhe respektin reciprok, duke vlerësuar diferencat e secilit;
- të favorizohet çdo formë përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara , ose në kushte disavantazhi socio-kulturor, të fëmijëve dhe familjeve me sfond migrator , të mbështesin edukimin gjinor, si njohje dhe respekt për të tjerët, duke ndjekur eliminimin e çdo dallimi mes seksit dhe gjinisë, fetar, etnik, grup social, nënshtetësive të huaja apo atyre pa shtetësi;
- të kujdesen për trajnimin dhe rinovimin e personelit arsimor në shërbimet e çerdheve dhe të kopshteve komunale, me qëllimin për të garantuar arsimim dhe edukim të garantuara, drejtuar rritjes globale të numrit të fëmijëve,

- të kujdesen për trajnimin dhe rinovimin e personelit arsimor në shërbimet e çerdheve dhe të kopshteve komunale, me qëllimin për të garantuar arsimim dhe edukim të garantuara, drejtuar rritjes globale të numrit të fëmijëve,
- të njohin dhe vlerësojnë lojën e fëmijëve në epiqendër të përditshmërisë shkollore, i cili është mjet thelbësor i rritjes globale, sociale, emocionale dhe njohëse (zhvillimin e aftësive);
- për të mbështetur në këto shërbime , eksperienca dhe projekte mësimore, më e mundshmja inovacioni dhe nxjerrja në dukje e zhvillimit të "100 gjuhëve" të fëmijëve, në kujdesin ndaj vetes (përsa i përket identitetit, vetëvlerësimi dhe vetëndërgjegjsimi), në kujdesin ndaj të tjerëve, brenda një perspektive, mirënjohje e respekti reciprok dhe në përkujdesje të ambijentit që na rrethon, si bazë për të kuptuar dashurinë për tokën-mëmë dhe gjitha gjallesat e saj;

- të promovojë modele të customer satisfaction (nevoja e klientave), dhe në fund të verifikojë mbarëvajtjen dhe cilësinë e përgjithshme të shërbimeve, duke bërë kujdes sugjerimive dhe treguesve të caktuar nga ana e familjeve, rrugëtimeve të vetëvlerësismit/vlerësimit të projekteve pedagogjike të çerdheve, në përputhje me legjislacionin aktual, si dhe rrugët analitike dhe parandalimin e formave të stresit nga puna, tek personeli arsimor dhe ndihmës;

- ti përmbahen me përpikmëri dhe me seriozitet dhe në mënyrë të detajuar, udhëzimeve të "Kritereve higjeno-sanitare gjatë pjesmarrjeve kolektive arsimore e shkollore" dhe në çdo disponim të Autoriteti Shëndetsor Vendor, si dhe rregulloret që kanë të bëjnë me sigurinë në vëndin e punës;
- për të pasuruar ofertën e trajnimit në çerdhe dhe të kopshte nëpërmjet përfshirjes së eskperteve - atelierëve, mediatorëve kulturor, etj.. dhe profesionistë që ndikojnë në formimin dhe edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (edukatorë, operatorë të rehabilitimit , specialistë të Ausl);
- në mënyrë që fëmijët të ndiqen dhe të mbështeten ashtu siç duhet, me profesionalitet, të shprehur nga një kujdes i veçantë
- me mirëkuptim e ndjeshmëri nga mësueset përkatëse, gjatë ciklit shkollor të marrë në tërësi, proçesin e mësimit në të gjitha fushat e zhvillimit, të përvetësimit të rregullave të përgjithshme për të gjithë, me pjesmarrjen aktive në komunitetin edukativ e mësimor, sipas grupmoshës së tyre, sipas shkallës së autonomisë dhe ndëgjegjësimit, për përvetësimin, në bashkëpunim me familjet, për sjelljen, bazuar në respektin ndaj shokëve dhe të rriturve dhe mirëkuptimin ndaj të tjerëve;

- **Prindi (apo përsoni me përgjegjësi prindërore ose kujdestari ) në veçanti deklaron:**

të angazhohen për respektimin e Kritereve higjeno-sanitarë, pjesmarrjen në kolektivin dhe grupin mësimor dhe shkollor", në fuqi dhe të pranojnë normat për "largimin e të miturit dhe efektet anësore gjatë pjesmarrjes" në rast të simptomave të mëposhtme ;

- temperaturë (mbi a 37.5°C)
- simptoma akute të frymëmarrjes si kollë apo rinitit( forma të ndryshme alergjie) me vështirësi në frymarrje
- të vjella (episode të përsëritura të shoqëruara me gjëndje jo të mirë, parahatie)
- diarre (tre ose më shumë shkarkime me fekale të lëngshme ose gjysmë të lëngshme)
- dhimbje koke intensive
- konjiktivit purulent (sekrecion në nivel të qepallave me ngjyrë të bardhë dhe të verdhë)
- parazit (psh. pedikuloza ose morrat)
- humbje e shijes dhe e nuhatjes (në mungesë të një gripi);

- në rast të largimit nga çerdhja/shkolla, për një vlerësim klinik të situatës, të aktivizoheni për të telefonuar dhe informuar Mjeken e familjes ose mjeken e mjeksisë së përgjithshme , për masat e mjekimit dhe për kohën që i duhet të rrijë në shtëpi;

- të pranohen dispozitat në lidhje me rikthimin në shkollë, pas mungesës për arsye shëndetsore, ose treguesi i të mbajturit në shtëpi të fëmijës subjekt i largimit nga shkolla për një ditë, duke përjashtuar ditën e tërhqjes nga shkolla dhe të vlerësohet rikthimi në shkollë, në momentin që simptomat e paraqitura janë zhdukur;
- të jenë të vetëdijshëm dhe të pranojnë që gjatë frekuentimit të fëmijës, në rast temperature sipër 37,5° ose simptomave të tjera të dyshimta, që pëmendëm më sipër si dhe sipas Kritereve Higjeno-Sanitar, gjatë frekuentimit të një grupi mësimor dhe shkollor, personeli i shkollës do të marrë masat ta mbajë larg shokëve, deri sa të shkojë ta tërheqë një familjar;
- të përkushtohet që të njoftojë personelin, mësueset e çerdhes/kopshtit , në lidhje me mungesat qoftë për arsye shëndetsore ose familjare të fëmijës së tij, në kuadrin e një respekti dhe mirëkuptimi reciprok
- që të jetë i vetëdijshëm që, ambjentimi i fëmijëve është një proçes delikat, në lidhje me të cilin është e rëndësishme të ndiqen udhëzimet e mësuesve, në lidhje me oraret , orarin e drekës, të gjumit sidomos në çerdhe dhe realizohet për grupet e vogla dhe të mëdha të kopshtit, duke përdorur dhe hapësirat e jashtme;
- të jenë të vetëdijshëm që në shërbimet për ciklin 0-6 të Komunës së Ravenës, promovohet pjesmarrja e familjeve në jetën shkollore përmes metodave formale (Komiteti i pjesmarrjes përbërë nga një nga prindrit dhe mësuesi, me funksion informues dhe parashikues mbi projektimin mësimor të Institutit, asambleja e përgjithme e prindëve e cila i bashkon si një " komunitet shkollor", të cilën e ndjek, në vazhdim, asambleja e seksioneve dhe intervistat individuale)si dhe metodat joformale (festa, laboratore, shëtitje ose eskursione);

- të jenë të vetëdijshëm që është e detyrueshme pjesmarrja në jetën shkollore të fëmijës së tij, nën një këndvështrim aleance dhe bashkëpunimi reciprok mes mësuesve dhe prindërve dhe që pjesmarrja e vazhdueshme që bëhet me dëshirën e prindërve, krijon qetësi tek fëmija i tyre, e cila pastaj mund të pasqyrohet në favor të jetës dhe aktivitietit shkollor;
- të jenë të ndërgjegjshëm që në ciklin parashkollor komunal nuk parashikohet gjumi, për motive strukturale dhe organizuese,por që kompensohet përmes një organizimi të hapësirave të seksionit favorizuese në momente pushimi të fëmijëve që kanë nevojë(lodhje) fizike, pas dreke, përmes "këndeve të buta" , sidomos nëpër seksione që mirëpresin fëmijë 3 vjeç ;
- të jenë të vetëdijshëm që gjithë çerdhet dhe kopshtet e Bashkisë së Ravenës ndjekin parimet e outdoor education( edukim në natyrë), përgjatë gjithë ciklit mësimor, të cilat dallohen fort nga daljet jashtë (dhe në zonën përreth) dhe nga eksperiencat edukative-didaktike, të cilat bazohen në kontaktin me natyrën, dhe në rast moti te keq (dimër) dhe për eskplorimin e botës natyrore, e jetuar në pasurinë dhe burimet , të cilat kontribuojnë në rritjen e kompetencave të fëmijëve dhe që janë ndonjëherë të dallueshme nga një rrezik minimal i llogaritur (të ngjiten, manipolojnë pjesë të vogla trungjesh dhe materialesh naturale në përgjithësi etj..);
- të jenë të vetëdijshëm që në shërbimet e ciklit 0-6 vjeç, komunale promovohet vazhdimsia mësimore, në kalimin që bëhet nga çerdhja në kopsht dhe në shkollë fillore, përmes mbledhjes mes mësuesish, përdorimi i skedave informative dhe përgatitjen e projekteve të përbashkëta, konkretisht në kalimin nga kopshti në shkollën fillore , në bashkëpunim me Institutët e vendit, që parashikojnë institutë të rinj, ndarjen e eksperiencave dhe laboratoreve inovative;
- të jenë të vetëdijshëm që, gjatë orarit të hyrjes në çerdhe nga ora 7.30 deri në orën 8.00 dhe orari i fillimit te kopshteve , gjithmonë nga ora 7.30 në orën 8.00, të fëmijës do shoqërohet nga një mësuese e institutit, në pritje të ardhjes së mësueses së seksionit përkatës, të vëmendshme,

ndaj numrit të fëmijëve , të cilët përdorin shërbimin e orarit më herët në mëngjes në kopshte (atëherë kur grupi rezulton i përbërë prej më shumë se 25 fëmijësh, mund të jetë e pranishme një mësuese e dytë e shkollës, në orarin shkollor nga ora 7.30 deri në orën 8.00, sipas një rrotullim turnesh, të përcaktuar nga vetë Shërbimi);

- të jenë të vetëdijshëm që, nëpër shkolla, që e ofrojnë shërbimin pas mësimit, parashikon që fëmijët frekuentues, mledhen nga seksione të ndryshme gjithë bashkë, të organizuar në një grup të vetëm dhe duke iu besuar një edukatoreje (dy në rast se janë prezentë më shumë se 25 fëmijë, të ndarë kështu , në dy grupe);
- të jenë të vetëdijshëm që, kur është e nevojshme për zëvendësimin e një mësuesje të seksionit që frekuenton fëmija juaj, pranë çerdhes apo kopshtit, zëvëndësimi bëhet sipas kriterit kryesor, me figura të qëndrueshme , dhe që mundësisht njihen nga fëmijët , të organizuar në mënyrën më të mirë të mundshme , si favorizuese për qetësinë dhe klimën mësimore, duke pohuar kështu dhe vlerën e ndërprerjes , si eksperiencë fëmijërore me karakter evolues;
- të jetë i vetëdijshëm që, në kufinjtë e një mirëorganizimi, është prezent personeli ndihmës në fushëveprimin e një instituti të vetëm dhe personeli mësimor, mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili mund të operojë dhe në më shumë institute/seksione, sipas lidhje me nevojat e fëmijëve;
- të jenë të vetëdijshëm që aktivitet e kualifikimit dhe pasurimit të ofertës mësimore të gjithë fëmijëve, mund të parashikojnë, prezencën e figurave të jashtme nëpër institute, (si për shëmbull, atelieristë, profesionistë, mediatorë kulturor, ose edukatorë dhe specialistë të Ausl(ndërmarrja e shërbimit shëndetsor publik) për realizimin e planeve mësimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara);
- të jenë të vetëdijshëm përsa i përket rëndësisë së respektimit të orarit të fillimit në çerdhe / kopsht, brenda orës 9.00; për vonesat, me përjashtim ngjarjesh madhore apo të veçanta, duhet ti komunikohen me telefon çerdhes apo shkollës brenda orarit të shkollës ; mungesa e korrektësisë ndërhyn në organizimin korrekt të përditshmërisë në shkollë, të pasqyruar në aktivitetet e rregullta dhe të lidhura zinxhir të cilat nuk i sigurojnë fmive që vinë me vonesë, pritjen e duhur , me një kohë të individualizuar, dhe dedikuar , nga ana e mësueseve që nuk duhen shkëputur nga aktivitetet e tjera (psh. banjo, koha e frutit etj..);
- të pranojnë që nuk i lejohet hyrja në shkollë më vonë dhe daljet para orarit të caktuar të që në fillim, vetëm për motive familjare dhe shëndetsore; kjo me qëllim që mos ti merret koha nga angazhimet të tjera jashtëshkollore si ato sportive, artistike etj., duke reduktuar kohën-shkollë dhe vlerën e saj edukative dhe rritje të parakoshme, e cila mund të çojë në të vërtetë " në një zhdukje të fëmijërisë";
- të pranojnë metodat e informimit dhe të komunikit me familjet, që përdoren nëpër çerdhe dhe kopshte komunale (internetin, chat-in e përshtatur të seksionit, dokumentat prej letre, të fotografuara etj..);
- firmosja e kësaj marrëveshje është shprehje e vullnetit dhe impenjimit të dy prindërve, në zbatim të Dispozitave të Kodit Civil (art. 316, 337 ter e 337 quater, ku thuhet që përgjegjësia prindërore ushtrohet nga të dy dhe që vendimet për fëmijët e tyre, të cilat lidhen me shkollimin, edukimin dhe shëndëtsinë do ishte mirë ti marrin bashkarisht. Për më tepër prindi që nënshkruan marrëveshjen, deklaron që ka firmosur duke respektuar dispozitat e mësipërme të kodit civil, që kërkojnë aprovimin e të dy prindëve.

Firmosja e aktit prezent këkon në mirëbesim impenjimin e të dy palëve për ta respektuar . Nga pikëpamja juridike, nuk i çliron nga asnjë përgjegjësi subjektet që e nënshkruajnë, në rast të mosrespektimit të rregulloreve në fuqi.

Kjo marrëveshje bashkëpërgjegjësie është e vlefshme për të gjithë ciklin mësimor.

Ravenna______________________________

| Prindi/Kujdestari me përgjegjësi prindërore | Drejtoresha e Shërbimit të Çerdheve dhe Kopshteve | Këshilltarja/i ligjor i Dadonew Consorzio Shërbimet Arsimore |
|---|---|---|
| | Laura Rossi | Francesca Travaglini |
| ______________________ | [signature] | [signature] |